


N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.  
RAPORTI VJETOR 2025





RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E  
 N.P.K. TRAFIKU URBAN SH.A. PËR VITIN 2025

Bordi i Drejtorëve të N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. miratoi Raportin Vjetor për vitin 2025 me nr. 880 në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.02.2026.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Qendrim Vitija, UD. Kryeshef Ekzekutiv	Ylber Çitaku, Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi:		
Data:	27.02.2026	27.02.2026



**Përmbajtja:**

<b>HYRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>I. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN .....</b>	<b>6</b>
<b>II. RAPORTI I KRYESUESIT TE BORDIT TE DREJTOREVE.....</b>	<b>7</b>
<b>III. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV .....</b>	<b>9</b>
3.1 Certifikimi i pagesave .....	11
3.2 Siguria dhe Shëndeti në Punë.....	12
3.3 Njësia e kontrollës së brendshme .....	13
3.4 Sektori i Sigurimit .....	14
3.5 Marketingu .....	14
3.6 Zyra për Informim.....	15
<b>IV. SEKRETARI .....</b>	<b>16</b>
<b>V. DREJTORIA E FINANCAVE .....</b>	<b>18</b>
<b>VI. DREJTORIA E ADMINISTRATES.....</b>	<b>22</b>
6.1 Zyra e Burimeve Njerëzore .....	23
6.2 Zyra Ligjore .....	24
6.3 Zyra e Teknologjisë Informative .....	25
<b>VII. DREJTORIA E PROKURIMIT.....</b>	<b>26</b>
<b>VIII. DREJTORIA E TRANSPORTIT .....</b>	<b>27</b>
<b>IX. DREJTORIA E MIRËMBAJTJES.....</b>	<b>32</b>
9.1 Sektori i Mirëmbajtjes .....	32
9.2 Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.....	34
<b>X. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>34</b>
10.1 Përfundim .....	34
10.2 Rekomandime.....	35
<b>Shtojca A: Pasqyrat Financiare të Ndërmarrjes.....</b>	<b>36</b>
<b>Shtojca B: Procedurat e Prokurimit në vitin 2025 .....</b>	<b>48</b>

## Shkurtesat

Tab. 1. Paraqitja listës së shkurtesave

Lista e shkurtesave	
TU	Trafiku Urban
NPK	Ndërmarrja Publike Komunale
SHA	Shoqëri Aksionare
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KSHP	Kontrata për Shërbim Publike
KSHP (PSC)	Kontrata për Shërbim Publik (Public Service Contract)
BD	Bordi i Drejtorëve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
SSHP	Siguria dhe Shëndeti në Punë
ZAB	Zyrtari për Auditim të Brendshëm
ZKFTH	Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit
PF	Pasqyrat Financiare
PA	Pasqyra e te Ardhurave
PSH	Pasqyra e Shpenzimeve
LLP	Llogari e Pagueshme
LLA	Llogari e Arkëtueshme
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
LPP	Ligji i Prokurimit Publik

## HYRJE

Raporti Vjetor i Ndërmarrjes Publike “Trafiku Urban” për vitin 2025 është hartuar në përputhje me nenin 31 pika 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Ky raport paraqet një pasqyrë të detajuar të performancës së ndërmarrjes gjatë vitit 2025, i cili shënon një nga vitet më të suksesshme në historinë e saj.

Gjatë këtij viti, menaxhmenti i ndërmarrjes ka arritur të realizojë me sukses objektivat kryesore, me fokus të veçantë në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e mirëqenies së punonjësve, me qëllim të avancimit të përgjithshëm të cilësisë së shërbimeve për komunitetin.

Përmirësimet e realizuara përfshijnë sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë punonjësit, rritjen e shujtës, miratimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës, përmes së cilës janë rritur dhe nivelizuar pagat. Këto masa kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e motivimit të stafit dhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Përveç kësaj, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë aktivitete të vazhdueshme për promovimin e shërbimeve të transportit publik, me qëllim të inkurajimit të qytetarëve që ta përdorin atë si alternativë kryesore për lëvizje brenda qytetit. Si rezultat i rritjes së numrit të përdoruesve, është paraqitur nevoja për zgjerimin e flotës, e cila në bashkëpunim me BERZH është në fazën përfundimtare për blerjen e 30 autobusëve të rinj.

Plani vjetor i punës për vitin 2025 është zbatuar me përpikëri, në përputhje me objektivat e përcaktuara nga drejtorit dhe njësitë përkatëse, si dhe me prioritetet strategjike të ndërmarrjes. Aktiviteti kryesor i Ndërmarrjes Publike “Trafiku Urban” mbetet transporti i udhëtarëve, përkatësisht ofrimi i shërbimeve të transportit publik në Komunën e Prishtinës.

Raporti vjetor përfshin analiza të detajuara mbi aktivitetin financiar, të ardhurat dhe shpenzimet, operativën, investimet, si dhe informacione të tjera të rëndësishme për funksionimin e ndërmarrjes.

Ndërmarrja Publike Komunale “Trafiku Urban” ka përmbyllur vitin 2025 me një rekord historik duke regjistruar një numër rekord mbi 20 milion përdoruesish. Ky rezultat shënon vitin më të suksesshëm në funksionimin e ndërmarrjes dhe dëshmon rritjen e vazhdueshme të besimit të qytetarëve në transportin publik.

Kjo arritje përbën një motivim të rëndësishëm për vazhdimin e përpjekjeve dhe përmirësimeve edhe në të ardhmen, me synim ruajtjen e standardeve të larta të shërbimit dhe kontributin e vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Prishtinës.



## I. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë ushtron veprimtarinë e transportit të udhëtarëve në linjat urbane dhe urbane-periferike me qëllim të organizimit të jetës dhe punës së qytetarëve dhe hyn në rangun e veprimtarive tjera shërbyese komunale. Për shkak të rëndësisë që ka ky shërbim i veçantë, ka filluar të kryhet në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës që nga dt. 01.04.1976 kur ndërmarrja "Trafiku Urban" u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale (N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.). Ky organizim është ndërmarrë me qëllim që qytetarëve t'u ofrohet transport i organizuar, i cili do të ndikojë në siguri dhe zvogëlim të dendësisë së trafikut në rrugët e qytetit. Pas luftës së vitit 1999 ndërmarrja është regjistruar si subjekt afarist pranë administratës së përkohshme të OKB-së (UNMIK) me dt. 22.06.2000 nën numrin e regj. 80060459 dhe është ri - regjistruar me dt. 22.06.2004 pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës me nr. e regj. të biznesit: 70163585 dhe nr. Unik identifikues 811289009, nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/ L-111 të dt. 20.04.2012 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Komunale nr. 03/ L-087 NPK "Trafiku Urban" SHA është regjistruar si Ndërmarrje Publike Komunale SH.A. në Prishtinë.

**Tab. 2. Veprimtaria dhe adresa e ndërmarrjes**

Nr.	EMRI I NDËRMARRJES	NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE "TRAFIKU URBAN" SHA PRISHTINË
1.	Adresa	Rr. Tahir Zajmi nr. 43, 10 000 Prishtinë
2.	Themelimi	01.04.1976 – Prishtinë, me ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.04/ L-111 është emërtuar si Ndërmarrje Publike Lokale.
3.	Themelues	Kuvendi Komunal i Prishtinës
4.	Prona	Pronë Publike Komunale
5.	Veprimtaria kryesore e Ndërmarrjes	4931 - Transporti rrugor urban dhe ndër-urban i pasagjerëve.
6.	Veprimtari sekondare e Ndërmarrjes	4939 - Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.; 4520 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve; 4671 - Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to.
7.	Të punësuar	Ndërmarrja ka të punësuar 475 punëtorë të rregullt.
8.	Pasuria	Pasuria e patundshme është në proces të definimit të titullarit, ndërsa pasuria e luajtshme e ndërmarrjes përbëhet nga 51 autobusë urban, vetura, vegla, pajisje dhe makinat të punës për mekanikë.
9.	Menaxhimi	Ndërmarrja menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve dhe mbikëqyret nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
10.	Regjistrimi	Ndërmarrja mban regjistrimin e biznesit pranë MTI së Kosovës nr. regj. Biz.: 600215611 dhe nr. Unik Identifikues: 811289009

## II. RAPORTI I KRYESUESIT TE BORDIT TE DREJTOREVE

Raporti Vjetor për vitin 2025 i N.P.K. "Trafiku Urban" Sh.A. Prishtinë paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar aktivitetet, vendimmarrjen dhe proceset kryesore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar angazhimin e Bordit të Drejtorëve dhe të menaxhmentit për funksionim të rregullt, transparent dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Në cilësinë time si Kryesues i Bordit të Drejtorëve, përmes këtij raporti hyrës synoj të ofroj një pasqyrë të përgjithshme mbi punën e Bordit gjatë vitit 2025, si dhe kontekstin institucional në të cilin janë zhvilluar aktivitetet e Ndërmarrjes, të detajuara më tej në raportet vjetore të njësisive përkatëse.

Gjatë periudhës raportuese, Bordi i Drejtorëve ka ushtruar përgjegjësitë e tij përmes mbajtjes së 12 mbledhjeve (11 të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme), në të cilat janë shqyrtuar çështje të rëndësishme që lidhen me qeverisjen e brendshme, menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin strategjik dhe funksionimin e përgjithshëm të Ndërmarrjes. Si rezultat i këtyre mbledhjeve dhe takimeve punuese, janë nxjerrë gjithsej 34 vendime të natyrave të ndryshme, të cilat kanë kontribuar në stabilitetin institucional dhe avancimin e proceseve të brendshme.

Një fokus i veçantë gjatë vitit 2025 ka qenë përditësimi dhe konsolidimi i kornizës normative të Ndërmarrjes. Në këtë drejtim, Bordi ka miratuar një numër të konsiderueshëm aktesh të brendshme, si dhe plotësim-ndryshime të rregulloreve ekzistuese, me qëllim të qartësimit të strukturës organizative, rregullimit të marrëdhënieve të punës, sistemit të pagave dhe kompensimeve, si dhe forcimit të standardeve të etikës dhe përgjegjësisë institucionale. Njëkohësisht, janë shfuqizuar akte të mëhershme të cilat nuk i përgjigjeshin më nevojave aktuale të Ndërmarrjes.

Në fushën e planifikimit strategjik dhe financiar, Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar dhe miratuar rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2025, si dhe Planin e Biznesit për vitin 2026, duke siguruar vazhdimësi në planifikim dhe orientim të qartë drejt objektivave zhvillimore të Ndërmarrjes. Këto dokumente strategjike përbëjnë bazën për veprimet operative dhe investuese në periudhën në vijim.

Gjatë vitit raportues janë zhvilluar gjithashtu takime informuese dhe punuese me njësinë e implementimit të projektit (PIU) dhe partnerët relevantë, me theks të veçantë në proceset që ndërlidhen me projektet kapitale dhe bashkëpunimin me BERZH-in për çështje që lidhen me flotën e autobusëve. Këto takime kanë shërbyer për rritjen e koordinimit ndërinstitucional dhe informimin e vazhdueshëm të Bordit lidhur me zhvillimet kryesore.

Në përmbyllje, vlerësoj se viti 2025 ka qenë një vit i konsolidimit të mëtejshëm institucional për N.P.K. "Trafiku Urban" Sh.A., ku përmes vendimmarrjes së qëndrueshme dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit dhe stafit, janë krijuar parakushte të rëndësishme për funksionim më efikas dhe zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Shpreh falënderimin tim për të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, menaxhmentin dhe punonjësit e Ndërmarrjes për angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë vitit 2025, si dhe për partnerët institucionalë për bashkëpunimin e vazhdueshëm.

**Raporti i Kompensimi Vjetor për Bordin e Drejtorëve.**

Gjatë vitit 2025 pagesat e Drejtorëve të Bordit në pajtim me ligjet në fuqi dhe të njëjtat janë tatimuar 10% (punë dytësore). Pagat vjetore bruto janë bërë bazuar në vendimin e aksionarëve me nr.805 të datës 27.02.2019 - protokollit të Ndërmarrjes dhe me nr. 14-120/06-0046907/19 datë 27-02-2019 – protokollit të Komunës së Prishtinës.

Pavarësisht sfidave, Bordi ka arritur të mbajë kursin drejt objektivave të tij dhe të sigurojë përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve, rrjedhimisht ky raport pasqyron përkushtimin dhe angazhimin e BD e me te edhe të Kryesuesit të Bordit për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të avancuar të NPK. “Trafiku Urban” ShA. Prishtinë.

### III. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Raporti vjetor paraqet në mënyrë të strukturuar, të qartë dhe profesionale veprimtarinë e realizuar nga Ndërmarrja Publike Komunale “Trafiku Urban” SH.A. gjatë vitit 2025. Dokumenti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi performancës e ndërmarrjes, arritjet kryesore, sfidat e hasura, progresin institucional si dhe drejtimet strategjike që kanë karakterizuar këtë vit raportues.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka operuar në një mjedis dinamik dhe sfidues, të karakterizuar nga rritja e kërkesës për shërbime cilësore të transportit publik, nevoja për optimizim të vazhdueshëm të proceseve operative dhe përshatje me zhvillimet urbane dhe infrastrukturore. Në këtë kuadër, fokusi kryesor ka qenë përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të transportit publik, efikasitetit operacional, modernizimi i proceseve të punës, si dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe mirëqenies së punonjësve.

Raporti reflekton angazhimin e vazhdueshëm të menaxhmentit dhe të gjithë stafit për realizimin e objektivave strategjike, avancimin e cilësisë së shërbimeve, zhvillimin dhe fuqizimin e burimeve njerëzore, si dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar transparencës, përgjegjshmërisë institucionale dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve.

#### **Performancës financiare**

Ndërmarrja pas disa viteve ka shënuar përmirësim të dukshëm financiar në vitin 2025, duke përmbyllur vitin me fitim neto prej 268,106.00€. Të hyrat kanë shënuar rritje të vazhdueshme gjatë periudhës 2022–2025, duke arritur nivelin më të lartë në vitin 2025 me 10,060,675 €, kryesisht falë përmirësimit të performancës operative, faturimit sipas PSC dhe së fundmi gjenerimi i të hyrave nga marketingu.

Megjithëse shpenzimet operative dhe administrative kanë ndjekur trend rritës, në vitin 2025 rritja e të hyrave ka tejkalar rritjen e shpenzimeve, duke ndikuar pozitivisht në rezultatin financiar. Shpenzimet financiare në vitin 2025 kanë shënuar ulje krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i menaxhimit më të mirë të obligimeve financiare.

Në tërësi, viti 2025 reflekton stabilitet dhe rikthim në fitim, duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm financiar të ndërmarrjes.

#### **Menaxhimi i Brendshëm**

Gjatë vitit 2025, janë realizuar një sërë veprimesh me rëndësi të veçantë për forcimin e qeverisjes së brendshme dhe përmirësimin e funksionimit organizativ të ndërmarrjes.

Gjatë vitit janë marrë vendime për hapjen e konkurseve të brendshme dhe të jashtme për pozita drejtuese, profesionale dhe operative, me qëllim të forcimit të kapaciteteve njerëzore, sigurimit të barazisë së mundësive dhe rritjes së efikasitetit organizativ.

Zhvillimi i burimeve njerëzore ka qenë një nga prioritetet kryesore gjatë vitit 2025. Në këtë drejtim, janë harmonizuar dhe përditësuar disa rregullore të brendshme, duke krijuar një kornizë më të qartë, funksionale dhe transparente për menaxhimin e brendshëm të ndërmarrjes.

Procesi i vlerësimit të performancës është finalizuar me sukses dhe ka shërbyer si bazë për identifikimin e nevojave për trajnime, ngritje profesionale dhe avancim të kapaciteteve të stafit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve.

Si masë motivuese dhe mbështetëse për punonjësit, gjatë vitit 2025 është rritur vlera e shujtës ditore nga 5€ në 7€, duke reflektuar përkushtimin e ndërmarrjes për përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së stafit.

Po ashtu, gjatë këtij viti është realizuar riorganizimi i zyrave të administratës dhe janë siguruar ambiente të reja pune, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e funksionalitetit dhe efikasitetit të organizimit të brendshëm.

### **Projekte dhe Bashkëpunime Strategjike**

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka avancuar ndjeshëm bashkëpunimet strategjike me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të transportit publik, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe sigurimit të qëndrueshmërisë financiare.

Gjatë vitit janë nënshkruar marrëveshje dhe kontrata të rëndësishme me Komunën e Prishtinës, ndërmarrje publike dhe institucione të tjera.

Bashkëpunimi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kompaninë konsulentë ARUP dhe Njësinë për Implementimin e Projekteve (PIU) ka qenë i vazhdueshëm dhe i fokusuar në projektin për blerjen e autobusëve të rinj, duke adresuar në mënyrë të koordinuar aspektet financiare, ligjore dhe mjedisore të këtij projekti strategjik. Gjatë këtij viti kanë përfunduar të gjitha procedurat duke përfshirë edhe vlerësimin e ofertave për autobusët dizel, ndërsa procesi i vlerësimit të autobusëve elektrik është në proces dhe do të përfundoj në tremujorin e parë të vitit 2026.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar takime të rregullta me Bordin e Drejtorëve, Kryetarin e Komunës dhe përfaqësues të tjerë institucional për monitorimin e procesit dhe koordinimin e planeve strategjike.

### **Digjitalizimi dhe Modernizimi i Shërbimeve**

Viti 2025 ka shënuar hapa të rëndësishëm në procesin e digjitalizimit dhe modernizimit të shërbimeve të transportit publik. Është realizuar hapja e llogarisë IBAS dhe ka filluar implementimi i “Kuletës Digjitale” në autobusë.

Stafi operativ, përfshirë kontrollorët dhe konduktorët janë trajnuar për përdorimin e sistemeve të reja digjitale, duke siguruar një implementim efikas dhe të qëndrueshëm.

Ndërmarrja për herë të parë ka filluar implementimin e një software-i gjithëpërfshirës, i cili mundëson digjitalizimin e të gjitha njësive organizative. Ky proces përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit të plotë të proceseve të brendshme dhe rritjes së efikasitetit operativ të ndërmarrjes.

Ndërmarrja ka rritur dukshëm angazhimin publik dhe komunikimin me qytetarët gjatë vitit 2025. Janë realizuar aktivitete dhe fushata në bashkëpunim me ngjarje kulturore dhe sociale, si dhe janë mbështetur iniciativa humanitare dhe fushata sensibilizuese.

Janë zhvilluar intervista dhe prononcime për media me qëllim rritjen e transparencës, informimin e publikut mbi gjendjen dhe prezantimin e planeve për të ardhmen. Këto aktivitete kanë kontribuar në forcimin e besimit publik dhe përmirësimin e imazhit institucional.

Gjithashtu është nënshkruar një kontratë për ofrimin e shërbimeve të marketingut, konkretisht për brendimin e autobusëve. Kjo kontratë ka kontribuar në rritjen e të hyrave të ndërmarrjes përmes shfrytëzimit të hapësirave reklamuese.

Në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv veprojnë disa njësi, të cilat bashkëveprojnë ngushtë për realizimin e objektivave strategjike dhe operacionale të Ndërmarrjes, të cilat janë: Certifikimi i Pagesave, Siguri dhe Shëndeti në Punë, Njësia e Kontrollit të Brendshëm, Sektori i Sigurimit, Marketingu, si dhe Zyra e Informimit.

Këto njësi kontribuojnë në mbarëvajtjen, transparencën dhe efikasitetin e proceseve të brendshme, duke mbështetur menaxhimin në ushtrimin e përgjegjësive dhe në arritjen e rezultateve të qëndrueshme.

### 3.1 Certifikimi i pagesave

Bazuar në planifikimin dhe dinamikën e punës gjatë vitit 2025, është realizuar certifikimi i shpenzimeve buxhetore përmes procedurave të prokurimit në N.P.K. "TRAFIKU URBAN" Sh.A.

Para autorizimit të pagesave që rrjedhin nga kontratat publike, është bërë verifikimi i plotë i përmbushjes së të gjitha kushteve të zbatueshmërisë. Të gjitha pagesat autorizohen vetëm pas verifikimit të plotë të përputhshmërisë ligjore, financiare dhe procedurale, duke ruajtur integritetin e procesit dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike. Me qëllim të garantimit të transparencës dhe ligjshmërisë në shpenzimin e parasë publike, procesi i certifikimit është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe në përputhje të plotë me rregulloret dhe procedurat e brendshme të ndërmarrjes.


Certifikimi i lëndëve kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të llogaridhënies së menaxherëve të projekteve, në forcimin e kontrollit financiar mbi shpenzimet e realizuara, si dhe në sigurimin e një evidence të saktë, të plotë dhe të verifikueshme të aktiviteteve financiare.

Raporti i lëndëve të certifikuara është përmbledhur në formë tabelore në vazhdim::

**Tab. 3. Raporti i lëndëve të certifikuara**

Nr. rendor	Llojet e procedurave të certifikimit	Numri total i lëndëve të certifikuara gjatë vitit 2025	Vlera totale (EUR)
1.	Certifikimi i lëndëve përmes procedurave të prokurimit	302	3,803,759.55
2.	Certifikimi i lëndëve me marrëveshje/kontrata	116	79,334.77
3.	Certifikimi i lëndëve me para të imët (Petty Cash)	112	6,462.89

**Grafiku 1.**



### 3.2 Siguria dhe Shëndeti në Punë

Siguria dhe shëndeti në punë përbëjnë një nga prioritetet kryesore të Ndërmarrjes Publike “Trafiku Urban”, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë dhe përgjegjësinë e lartë ndaj punonjësve dhe qytetarëve.

Qëllimi kryesor i ndërmarrjes ishte krijimi dhe ruajtja e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme të punës, parandalimi i aksidenteve, lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale, si dhe mbrojtja e jetës dhe mirëqenies së punonjësve.

Përmes zbatimit të masave parandaluese, trajnimeve të vazhdueshme dhe respektimit rigoroz të legjislacionit në fuqi, Trafiku Urban ka minimizuar rreziqet në vendin e punës dhe ka ofruar një mjedis pune të qëndrueshëm, efikas dhe të sigurt për të gjithë punonjësit.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar aktivitetet në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si vijon:

- Evidentimi dhe trajtimi i lëndimeve në punë dhe rreth punës.
- Inspektimi i vend punishteve
- Dhënia dhe zbatimi i rekomandimeve përkatëse;

#### Evidentimi dhe trajtimi i lëndimeve në punë apo rreth punës

Gjatë vitit 2025 nuk kemi pësuar asnjë lëndim. Gjatë këtij viti ndërmarrja ka plotësuar kuadrin ligjor të vlerësimit të riskut.

Shëndeti dhe siguria në punë janë pjesë e pandashme e organizimit të punës në ndërmarrjen N.P.K. “Trafiku Urban” SH.A. ku pjesë e Sistemit të menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë është edhe Vlerësimi i Riskut.

Përmes vlerësimit të riskut janë identifikuar të gjitha çështjet që mund të dëmtojnë punëtorin dhe që mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme.

Qëllimi i vlerësimit të riskut ka të bëjë me zvogëlimin e mundësisë së lëndimeve dhe eliminimin e disa rreziqeve nëse është e mundshme nëse nuk është e mundshme atëherë bëhet vlerësimi i këtyre rreziqeve me qëllim që të ulen në nivelin e pranueshëm.

#### Inspektimi i vend punishteve

Inspektimi i vend punishteve është bazuar në planifikimin e menaxhmentit dhe ato ad-hoc.

**Tab. 4. Llojet e inspektimeve në vend punishte**

LLOJET E INSPEKTIMEVE	DATA
Inspektime rutinore	Në bazë javore
Inspektime të planifikuara	Çdo muaj

#### Rekomandimet të ndryshme

Gjatë kësaj kohe janë dhënë gjithsej 3 (tri) rekomandime.

**Tab. 5. Rekomandimet e dhëna**

REKOMANDIM	DATA
Rekomandim për furnizim me material të kutive të ndihmës së parë	13/11/2025
Rekomandim për kontrollë sistematike të gjitha instalimeve elektrike në ndërmarrje	20/11/2025
Rekomandim për respektimin e masave mbrojtëse në punë	30/12/2025

### 3.3 Njësia e kontrollës së brendshme

Gjatë vitit 2025, Njësia e Kontrollës së Brendshme ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar, duke përshtatur kapacitetet njerëzore sipas nevojave operative.

Në fillim të vitit 2025, Njësia e Kontrollës së Brendshme ka funksionuar me 13 kontrollorë. Me zgjerimin e fushëveprimit të kontrollës edhe ndaj operatorëve të transportit privat, struktura e njësisë është rritur në 18 kontrollorë, të organizuar në tri ekipe funksionale, secili i përbërë nga 6 punonjës.

#### **Ndërrimet e punës gjatë gjithë vitit:**

- Ndërrimi I: 06:00 – 14:00
- Ndërrimi II: 14:00 – 22:00
- Ndërrimi III: 16:00 – 24:00

Ky organizim ka siguruar mbulim të plotë ditor, kontroll të vazhdueshëm në të gjitha ndërrimet dhe reagim të shpejtë ndaj parregullsive.

#### **Transporti i Mbuluar nga Kontrolla**

Gjatë vitit 2025, Njësia ka ushtruar kontroll mbi:

- 51 autobusë të NPK “Trafiku Urban” Sh.A.
- 84 autobusë të operatorëve privat

#### **Orari i operimit:**

- Trafiku Urban: 06:00 – 24:00
- Operatorët privat: 06:00 – 22:00 (disa linja deri në 24:00)

Çdo autobus është kontrolluar në mënyrë të përsëritur, në orare dhe ndërrime të ndryshme, për të garantuar rritje të disiplinës operative.

#### **Qëllimi dhe Metodologjia e Kontrollit**

Kontrolli gjatë gjithë vitit është fokusuar në:

- Verifikimin e kuponëve fiskalë,
- Kontrollin e biletave mujore dhe kartelave për udhëtime pa pagesë,
- Verifikimin e X-raporteve nga arkat fiskale,
- Parandalimin e përdorimit të kartelave të falsifikuara, të tjetërsuara ose të përdorura nga persona të paautorizuar,
- Monitorimin e:
  - Prezencës së stafit,
  - Respektimit të orarit,
  - Kodit të veshjes,
  - Sjelljes profesionale ndaj pasagjerëve,
  - Pastërtisë dhe respektimit të itinerarit.

Gjatë vitit 2025, Njësia e Kontrollës së Brendshme ka funksionuar në mënyrë të rregullt, të planifikuar dhe efektive, duke garantuar mbikëqyrje të qëndrueshme të transportit publik urban dhe privat.

Megjithëse janë evidentuar parregullsi të herëpashershme, kryesisht te operatorët privatë, gjendja e përgjithshme e operimit ka qenë e qëndrueshme, ndërsa digjitalizimi i pagesave përfaqëson një progres të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

### 3.4 Sektori i Sigurimit

Gjatë vitit 2025, Sektori i Sigurimit ka përmbushur me përgjegjësi detyrat e tij në garantimin e sigurisë së objektit të ndërmarrjes. Hyrjet dhe daljet janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë evidentuar rregullisht në librin e raporteve të sigurimit, pa u konstatuar asnjë vërejtje apo parregullsi.

Në kuadër të masave parandaluese, gjatë orarit të punës janë realizuar kontrolle rutinë brenda objektit, si dhe kontrolle të rregullta gjatë vikendeve. Gjatë këtyre inspektimeve nuk janë evidentuar probleme apo situata të jashtëzakonshme.

### 3.5 Marketingu

N.P.K. “TRAFIKU URBAN” Sh.A. në muajin Shtator 2025 ka lidhur kontratë me një Operator Ekonomik për ofrimin e Shërbimeve të Marketingut. Sipas kontratës operatori i jashtëm ka për obligim të menaxhoj hapësirat reklamuese të autobusëve.

Gjatë kësaj periudhe, që nga nënshkrimi i kontratës deri në fund të muajit Dhjetor 2025 janë brenduar 21 autobusë dhe aktivitetet janë zhvilluar në përputhje me kontratën e nënshkruar, planin e punës dhe afatet e kontraktuara, njëkohësisht duke i respektuar dhe hapësirat reklamuese.

**Foto. 1. Brendimi i autobusëve nga operatori ekonomik**



Trafiku Urban, në mbështetje të një prej ngjarjeve më të mëdha kulturore dhe muzikore në vend dhe rajon, në bashkëpunim me Festivalin “Sunny Hill” dhe Komunën e Prishtinës, ka organizuar ofrimin falas të shërbimit të transportit publik për të gjithë qytetarët pjesëmarrës në këtë festival. Ky shërbim ka qenë në funksion gjatë të gjitha ditëve të festivalit, nga data 1 deri më 3 Gusht 2025, me qëllim të lehtësimit të qasjes dhe lëvizjes së qytetarëve drejt lokacionit të festivalit.

Në shtator, Zyra e Marketingut ka marrë pjesë në fushatën ndërkombëtare “Race For the Cure”, e cila synon ndërgjegjësimin kundër të kancerit të gjirit. Një autobus është brenduar me ngjyrë rozë, duke përcjellë

mesazhin e solidaritetit dhe mbështetjes për gratë që përballen me këtë sëmundje. Ky aktivitet ka kontribuar në rritjen e imazhit pozitiv të ndërmarrjes në publik dhe në promovimin e vlerave shoqërore.

### 3.6 Zyra për Informim

Komunikimi institucional me qytetarët përbën një element të rëndësishëm të funksionimit demokratik dhe transparencës publike. Gjatë vitit 2025, Trafiku Urban ka zhvilluar veprimtarinë e tij në përputhje me parimet e transparencës, informimit të drejtë dhe qasjes së barabartë për mediat, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë.

Zyra për Informim ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e saj, duke kontribuar në rritjen e transparencës institucionale dhe përmirësimin e komunikimit me publikun. Në këtë kuadër, Zyra e informimit ka ndjekur dhe koordinuar aktivitetet dhe takimet zyrtare të Ndërmarrjes dhe të Kryeshefit Ekzekutiv, ka përgatitur dhe shpërndarë komunikata për media, të cilat janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të Trafikut Urban dhe janë dërguar në mënyrë të rregullt tek mediat.

Gjatë vitit raportues, qytetarët janë informuar në kohë reale për ndryshimet eventuale në linjat e autobusëve, si pasojë e punimeve infrastrukturore dhe rregullimeve të përkohshme në rrugët e Kryeqytetit. Po ashtu, Zyra për Informim ka ofruar sqarime dhe informacione të vazhdueshme lidhur me situata të ndryshme që kanë ndodhur gjatë operimit të trafikut urban, me qëllim të informimit të saktë dhe në kohë të publikut.

#### Qasja në dokumente publike

Gjatë vitit 2025, Trafikut Urban i janë adresuar gjithsej dhjetë (10) kërkesa për qasje në dokumente publike. Prej tyre, katër (4) kërkesa kanë qenë nga mediat, një (1) kërkesë nga individë, si dhe pesë (5) kërkesa nga organizata joqeveritare (OJQ).

Të gjitha kërkesat janë trajtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për qasje në dokumente publike dhe janë aprovuar plotësisht brenda afateve ligjore, duke dëshmuar përkushtimin e institucionit ndaj transparencës dhe llogaridhënies publike.

#### IV. SEKRETARI

Në këtë raport vjetor për vitin 2025 janë të përfshira: mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të BD, numri i vendimeve të dala nga Bordi, takimet punuese të mbajtura gjatë kësaj periudhe, shfuqizimi dhe miratimi i Akteve të Brendshme të Ndërmarrjes dhe veprime tjera të cilat Sekretari i ka ndërmarr në raport me Bordin e Drejtorëve dhe Ndërmarrjen.

##### *Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve*

Si zyrtar i lartë i emëruar nga Bordi i Drejtorëve kam marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të mbajtura gjatë periudhës raportuese dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas ligjit duke dhënë këshilla ligjore, konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike si dhe Rregullores së Punës së Bordit dhe Komisionit të Auditimit, ligjeve dhe akteve të tjera në fuqi.

**Tab. 6. Mbledhjet e rregullta të regjistruara për vitin 2025**

	Konstituive	Të rregullta	Të jashtëzakonshme	Gjithsej
Mbledhje të Bordit të Drejtorëve	0	11	1	12

Nga të gjitha mbledhjet e mbajtura dhe takime tjera gjatë periudhës raportuese nga Bordi i Drejtorëve janë nxjerrë gjithsej 34 vendime të natyrave të ndryshme.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2025 Bordi i Drejtorëve ka miratuar Ri-shikimi i Planit të Biznesit të Ndërmarrjes për vitin 2025.

Me datë 31.10.2025 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve është miratuar Plani i Biznesit për vitin 2026.

**Takimet informuese PIU:** Me dt.13.06.2025, 18.06.2025 dhe 11.08.2025 janë mbajtur takime informuese mes Bordit të Drejtorëve, Zyrtarëve të Lartë dhe përfaqësuesit të ekipës PIU. Temë e diskutimit kanë qenë veprimet e ndërmarra nga PIU në raport me BERZH-in sa i përket flotës së re të autobusëve.

**Punëtoritë:** Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur dy punëtori.

**Punëtorja e parë** është mbajtur me datë 22 – 25 05.2025, ku si pika të trajtimit kanë qenë trajtimi i Draftit të Kodit të Etikës, Draft Rregullore mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale, Draft Rregullore për përdorimin e Automjeteve Zyrtare në Trafik Urban, Draft Rregullore për Marketing si dhe Draft Rregullore për Pagat dhe Kompensimet Tjera në Trafik Urban. Me ç ‘rast janë trajtuar dhe janë dhënë komente për të gjitha dokumentet, (të njëjtat janë miratuar në mbledhjen e rregullt të Bordit).

**Punëtorja e dytë** është mbajtur me datë 24 – 26.10.2024 ku është analizuar Draft Plani i Biznesit për vitin 2026. Në këtë punëtori janë inkorporuar të gjitha komentet e dhëna sa i përket Planit të Biznesit dhe i njëjti është miratuar në mbledhjen e rregullt të BD.

#### AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES

**Tab. 7. Aktet e brendshme të miratuara për vitin 2025**

Nr.	Akti	Data
1.	Kodi i Sjelljes dhe Etikës i N.P.K. “TRAFIKU URBAN” SH.A. Prishtinë	04.06.2025
2.	Rregullore 01/2025 mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale në NPK “Trafiku Urban” SHA	04.06.2025
3.	Rregullore nr. 02/2025 për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në NPK “Trafiku Urban” Sh.A.	04.06.2025

4.	Rregullore nr. 03/2025 për Pagat dhe Kompensimet Tjera në NPK. “Trafik Urban” Sh.A.	04.06.2025
5.	Rregullore nr. 04/2025 për Zbatimin e Aktiviteteve të Marketingut në Trafikun Urban Prishtinë 2289 Dt.04.06.2025	04.06.2025
6.	Rregullore nr. 05/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK “Trafiku Urban” Sh.A. Prishtinë	27.08.2025

**Tab. 8. Plotësim ndryshimi i Akteve të Brendshme për vitin 2025**

Nr.	Akti	Data
1.	Sipas Vendimit me nr.341 dt.31.01.2025 Plotësohet / Ndryshohet Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr.4417 dt, 04.12.2024.	31.01.2025
2.	Sipas Vendimit me nr.431 dt.07.02.2025 Plotësohet / Ndryshohet Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr.4417 dt, 04.12.2024.	07.02.2025
3.	Sipas Vendimit me nr.819 dt.11.03.2025 Plotësohet / Ndryshohet Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 4417 dt, 04.12.2024.	11.03.2025
4.	Sipas Vendimit me nr.1838 dt.12.05.2025 Plotësohet / Ndryshohet Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 4417 dt, 04.12.2024.	12.05.2025
5.	Sipas Vendimit me nr.2282 dt.04.06.2025 Plotësohet / Ndryshohet Rregullorja nr. 01/2024 mbi Përcaktimin e Kriteve, Procedurave dhe Nivelin e Kompensimit të Dëmeve në NPK. “Trafiku Urban” Sh.A. me nr. 3534 dt, 13.09.2024.	04.06.2025
6.	Sipas Vendimit me nr.2771 dt.30.06.2025 Plotësohet / ndryshohet Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 4417 dt, 04.12.2024.	30.06.2025
7.	Sipas Vendimit me nr. 5212 dt. 10.11.2025 Plotësohet / ndryshohet Rregullorja nr.05/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK “Trafiku Urban” SHA. Prishtinë, me nr. protokollit 3680 dt.27.08.2025.	10.11.2025

**Tab. 9. Shfuqizimi i Aktet e Brendshme për vitin 2025**

Nr.	Akti	Data
1.	Kodi i Sjelljes dhe Etikës me nr.184 dt.22.02.2018.	04.06.2025
2.	Rregullorja 02/2024 mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale në NOK. “Trafiku Urban” SHA. me nr. prot.4072 të datës 31.10.2024	04.06.2025
3.	Rregullorja nr. 01/2023 për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare në NPK, “Trafiku Urban” SHA. me nr. prot. 1803 të datës. 04.06.2023.	04.06.2025
4.	Rregullorja nr. 03/2022 për Pagat dhe Kompensimet Tjera në Trafik Urban Sh.A me nr. protokollit 2721 e datës 26.08.2022 si dhe Rregullorja nr. 02/2023 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores nr. 03/2022 për Pagat dhe Kompensimet Tjera në Trafik Urban Sh.A me nr. protokollit 2200 e datës 03.07.2023.	04.06.2025
5.	Rregullorja nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK. “Trafiku Urban” ShA. Prishtinë sipas protokollit nr.4417 dt.04.12.2024 si dhe plotësim ndryshimet sipas protokollit me nr.341 dt.31.01.2025, nr.431 dt.07.02.2025, nr.819 dt.11.03.2025, nr.1838 dt.12.05.2025 dhe nr.2771 dt.30.06.2025.	27.08.2025

## V. DREJTORIA E FINANCAVE

Raporti vjetor financiar i Ndërmarrjes Publike Komunale 'Trafiku Urban' Sh.A. për vitin 2025 paraqet performancën financiare të ndërmarrjes, duke analizuar të hyrat dhe shpenzimet e realizuara gjatë vitit. Ky raport ofron një pasqyrë transparente mbi situatën financiare të ndërmarrjes.

### Të hyrat e realizuara

Gjatë vitit 2025, të hyrat e realizuara janë si vijon:

- **Shitjet nga biletat:** 3,610,367.00 €

Përfshijnë shitjen e biletave ditore, mujore dhe të gjitha kategoritë e biletave të ofruara për qytetarët.

- **Faturimi sipas PSC:** 5,898,826.00 €

Kjo kategori përfshin pagesat e bëra nga Komuna e Prishtinës për kilometrat e operuara sipas marrëveshjes për shërbime publike (PSC).

- **Të hyrat nga bonusi sipas indikatorëve të performancës:** 177,159.00 €

Përfshijnë shpërblimet e fituara bazuar në përbushjen e indikatorëve të performancës, si niveli i shërbimit dhe cilësia e transportit publik.

- **Të hyrat nga marrëveshjet “në shtëpi”:** 223,413.00 €

Përfshijnë kontratën “ne shtëpi” për shërbime për instalimin e pajisjeve GPS ne autobusët e NPK Trafiku Urban dhe autobusëve te Sektorit privat ne mes TU dhe Komunës se Prishtinës dhe kontratën “ne shtëpi” për optimizimin, rritjen e efikasitetit dhe qasjen e integruar te transportit publik ne komunën e Prishtinës, si dhe marrëveshjen me komunën e Prishtinës për kompensimin e punëtorëve sipas komunikimeve elektronike.

- **Të hyrat nga marketingu:** 80,780.00 €

Përfshijnë të hyrat nga reklama të cilat realizohen nga kontrata qe ndërmarrja e ka te nënshkruar me operatorin ekonomik, për një autobus 600.00 euro në muaj.

- **Të hyrat tjera:** 70,455.00 €

Përfshijnë të hyrat nga kompensimi i dëmeve, të cilat vijnë nga aksidentet që ndodhin mes autobusëve të ndërmarrjes dhe palëve të treta, shitja e skrapit, përfshirë hekurishten, vajin dhe naftën, të cilat për vite me radhë kanë qëndruar në depon e ndërmarrjes dhe pas verifikimeve përkatëse është konstatuar se nuk janë për përdorim.


**Gjithsej të hyrat:** 10,060,675.00 €

Më poshtë po i paraqesim në mënyrë tabelore dhe grafike të hyrat për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2025.

**Tab. 10. Të Hyrat për vitin që përfundon më 31.12.2025**

Të Hyrat për vitin që përfundon më 31.12.2025	
Shitjet nga biletat	3,610,367.00
Faturimi PSC	5,898,826.00
të Hyrat nga Bonusi sipas indikatoreve të performances	177,159.00
Të Hyrat nga Marrëveshjet "në shtëpi"	223,413.00
Të Hyrat nga marketingu	80,780.00
Të Hyrat tjera	70,130.00
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>10,060,675.00</b>

**Grafiku 2. Të hyrat për vitin që përfundon më 31.12.2025**



### Përmbledhje Ekzekutive – Të Hyrat 2025

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2025, ndërmarrja ka realizuar të hyra totale në vlerën prej 10,060,675 €, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprahe. Struktura e të hyrave karakterizohet nga dominimi i faturimit sipas Marrëveshjes për Shërbime Publike (PSC) me Komunën e Prishtinës, i cili përbën burimin kryesor dhe më të qëndrueshëm të financimit.

Shitja e biletave ka kontribuar në mënyrë të rëndësishme në të hyrat totale, duke reflektuar një nivel të qëndrueshëm të shfrytëzimit të transportit publik nga qytetarët. Po ashtu, ndërmarrja ka realizuar të hyra shtesë nga bonuset e performancës, marrëveshjet specifike me Komunën, si dhe nga aktivitetet e marketingut dhe të hyrat tjera operative.


Në tërësi, struktura e të hyrave për vitin 2025 dëshmon për stabilitet financiar dhe diversifikim të burimeve të të hyrave, duke krijuar bazë të qëndrueshme për vazhdimësinë e operimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve të transportit publik.

## Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse – Analizë për Raportin Vjetor

Tab. 11. Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për periudhën 2022–2025

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse				
	Për fund vitin 31.12.2025	Për fund vitin 31.12.2024	Për fund vitin 31.12.2023	Për fund vitin 31.12.2022
Të Hyrat	10,060,675	8,995,349.00	9,063,585.00	7,626,573.00
Shpenzimet Operative dhe administrative	-9,541,435.00	(9,102,812.00)	-8,083,521.00	-7,784,721.00
Shpenzimet Financiare	(247,280.00)	(278,537.00)	(209,572.00)	-75,246
Të Hyrat/shpenzimet tatimore	96,146.00	96,146.00	49,645	43,293
Fitimi/Humbja Neto	368,106.00	289,854.00	820,137.00	-190,101.00

Grafiku 3. Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për periudhën 2022–2025



Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për periudhën 2022–2025 paraqet zhvillimet kryesore financiare të ndërmarrjes, duke reflektuar trendët e të hyrave, shpenzimeve dhe rezultatit financiar neto.

Gjatë kësaj periudhe, të hyrat e ndërmarrjes kanë shënuar rritje të përgjithshme, me një nivel prej 7,626,573 € në vitin 2022, duke u rritur në 9,063,585 € në vitin 2023 (përfshirë subvencionin nga komuna e Prishtinës prej 716,307.00€). Në vitin 2024 është evidentuar një rënie e lehtë e të hyrave në 8,995,349 €, ndërsa në vitin 2025 të hyrat kanë arritur vlerën prej 10,060,675 €, duke shënuar rritjen më të lartë në periudhën e analizuar. Kjo rritje reflekton kryesisht përmirësimin e performancës operative, veçanërisht nga faturimi sipas marrëveshjes për shërbime publike (PSC) dhe të hyrat nga shitja e biletave.

Shpenzimet operative dhe administrative kanë ndjekur një trend rritës gjatë gjithë periudhës, duke reflektuar rritjen e kostove të operimit, mirëmbajtjes së flotës dhe shpenzimeve të personelit. Në vitin 2022, këto shpenzime ishin në vlerën prej 7,784,721 €, ndërsa në vitin 2023 janë rritur në 8,083,521 €. Rritja më e theksuar është shënuar në vitin 2024, me shpenzime prej 9,102,812 €, ndërsa në vitin 2025 ato kanë arritur në 9,788,715.00 €. Megjithatë, rritja e të hyrave në vitin 2025 ka tejkaluar ritmin e rritjes së shpenzimeve, duke ndikuar pozitivisht në rezultatit financiar.

Shpenzimet financiare kanë shënuar luhatje gjatë periudhës raportuese. Nga 75,246 € në vitin 2022, ato janë rritur ndjeshëm në vitet 2023 dhe 2024, duke arritur respektivisht në 209,572 € dhe 278,537 €. Në vitin 2025 është evidentuar një ulje relative e shpenzimeve financiare në 247,280 €, duke reflektuar menaxhim më të kujdesshëm të obligimeve financiare dhe kostove të interesit.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve, fitimi/humbja para tatimit ka qenë negativ në vitin 2022 dhe 2024, ndërsa pozitiv në vitet 2023 dhe 2025. Në vitin 2025, ndërmarrja ka realizuar fitim neto në vlerën prej 368,106.00€, duke shënuar një përmirësim të dukshëm krahasuar me humbjen e vitit paraprak.

Fitimi/humbja neto paraqet një pasqyrë të qartë të performancës financiare të ndërmarrjes. Pas një humbjeje neto prej 190,101 € në vitin 2022, ndërmarrja ka realizuar një fitim të konsiderueshëm neto prej 820,137.48 € në vitin 2023, duke iu referuar subvencionit të cilin, pas kërkesës për mbulim të DSRA (llogari e pagesës së këstit kreditor BERZH), tek komuna e Prishtinës, si zotuese e marrëveshjes së kredisë, në llogarinë bankare të ndërmarrjes në dhjetor të vitit 2023 ishin transferuar 716,307.00 euro, e cila vlerë kishte rritur të hyrat dhe viti financiar 2023 rezultoi me këtë fitim neto. Viti 2024 është karakterizuar nga një humbje neto prej 289,854.31 €, për shkak të rritjes globale të çmimeve, të cilat kishin afektuar sidomos në çmimin e naftës dhe mirëmbajtjes së autobusëve dhe nga ana tjetër, ne akoma nuk kishim arritur përditësimin e çmimit për kilometër të kaluar sipas PSC, i cili u arrit në fund të vitit 2024 dhe kjo ishte arsyeja e bilancit negativ të këtij viti, ndërsa në vitin 2025 është shënuar rikthimi në fitim me një rezultat neto pozitiv prej 368,106.00 €.

Në përfundim, rezultatet financiare për vitin 2025 tregojnë stabilizim dhe përmirësim të gjendjes financiare të ndërmarrjes, duke krijuar bazë të qëndrueshme për planifikimin financiar dhe operativ të periudhës vijuese, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve të transportit publik.

## VI. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Drejtoria e Administratës ka një rol kyç në funksionimin e rregullt dhe stabil të NPK “Trafiku Urban” SH.A., duke siguruar zbatimin e procedurave administrative, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe respektimin e legjislacionit në fuqi. Gjatë vitit 2025, Drejtoria ka vepruar në përputhje me aktet e brendshme të Ndërmarrjes dhe objektivat strategjike të saj, duke kontribuar drejtpërdrejt në stabilitetin organizativ dhe rritjen e efikasitetit operacional.

Struktura e Drejtorisë së Administratës përbëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra Ligjore dhe Zyra e Teknologjisë Informative (TI), të cilat kanë bashkëpunuar ngushtë për realizimin e detyrave dhe përgjegjësiwe institucionale.

Në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, Zyra e Burimeve Njerëzore ka realizuar vlerësimin e performancës së punëtorëve për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, si dhe ka finalizuar Raportin e Vlerësimit të Performancës për periudhën janar–qershor 2025. Këto raporte kanë shërbyer si bazë për analizë të performancës individuale dhe organizative, identifikimin e pikave të forta, fushave për përmirësim dhe dhënien e rekomandimeve konkrete për rritjen e efektivitetit në punë. Raportet janë shpërndarë te menaxhmenti përmes email-it, në kuadër të transparencës dhe përfshirjes institucionale.

Janë zhvilluar disa aktivitete bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional, përfshirë takime me Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim në kuadër të projektit PIAKOS, Shoqatën e Matematikanëve të Kosovës për mbështetje logjistike në garën ndërkombëtare EGMO, si dhe me Rrjetin e Grave të Kosovës për realizimin e fushatës “16 Ditë Aktivizim kundër Dhunës ndaj Grave”, përmes vendosjes së materialeve sensibilizuese në autobusët e transportit publik.

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale, është aprovuar pjesëmarrja e punëtorëve në trajnime të specializuara, përfshirë trajnimet për “Menaxhimin e Kontratave” dhe “Menaxhimin e Kontratave Publike përmes platformës E-Prokurimi”, duke kontribuar në forcimin e njohurive ligjore dhe procedurale në fushën e prokurimit publik.

